

Lotaria për Shkollat e Mesme të Reja/Kensington 2014 Mars

Kush mundet të aplikojë?

Janë të mirëpritur për aplikime nxënësit e Drejtorisë Arsimore dhe ata jashtë saj.

A ka kritere pranimi për këto shkolla të mesme?

Asnjëra prej shkolla nuk ka kritere mësimore për pranim. Megjithatë, nxënësit që aplikojnë në shkollën e mesme Kensington CAPA, do t'u kërkohet një auditim për programet e artit, që ofrohen në këtë shkollë.

Si do të kryhet përzgjedhja e nxënësve për pranim në shkolla?

Të gjithë nxënësit do të përzgjidhen nga një lotari e kompjuterizuar.

- Për shkollat e Kensington – Preferenca do të kenë nxënësit që banojnë në kufijtë e zonës të shkollave të Kensingtonit.
- Për shkollat LINC dhe U School- 50% e vendeve të klasave të 9^{ta} do të plotësohen me nxënës të kodeve postare (zip codes): 19120, 19121, 19122, 19123, 19124, 19125, 19130, 19132, 19133, 19134 dhe 19140. Vendet e tjera në masën 50% do të plotësohen nga nxënës nga i gjithë qyteti.
- Për ndërtesën 21- 60% e vendeve të klasave të 9^{ta} do të plotësohen me nxënës të kodeve postare (zip codes): 19120, 19121, 19122, 19123, 19124, 19125, 19130, 19132, 19133, 19134, dhe 19140. Vendet e tjera në masën 40% do të plotësohen nga nxënës nga i gjithë qyteti.

A do të mundësohet miratimi në shkolla të ndryshme?

Po, nxënësi mund të përzgjidhet nga lotaria në disa shkolla të ndryshme.

Unë kam marrë pjesë në Proçesin e Përzgjedhjes së Shkollës së Mesme dhe kam marrë miratimin, ose jam në listën e pritjes të shkollës. Lotaria e e Shkollave të Reja të Mesme Kensington a e fshin këtë miratim, ose vendin në listën e pritjes?

Jo. Ky është një proçes i ndarë nga proçesi i Përzgjedhjes së Shkollës së Mesme. Në rast se ju merrni miratim, ose vend në listën e pritjes përmes lotarisë të Shkollave të Mesme të Reja Kensington, ju do të pyeteni të merrni vendimin përfundimtar për regjistrim në shkollat në të cilat jeni miratuar

Si dhe kur do t'a marr letrën për përfundimin e rezultateve të lotarisë?

Rezultatet e lotarisë do të publikohen gjatë javës së datës 9 Qershor 2014.

- Nxënësit e Drejtorisë do të marrin njoftim për rezultatet e lotarisë nëpërmjet Portalit të Nxënësit.
- Prindërit e nxënësve jashtë Drejtorisë do të marrin një email me njoftimin, që vendimi është në uebsajtin e Shkollave të Reja të Mesme Kensington.

A mund të marr ndihmë për aplikim në këto shkolla të mesme, në Qendrat Ndhmëse për Prindin dhe Familjen?

Po. Informacioni për proçesin e lotarisë të Shkollave të Mesme Kensington gjendet në Qendrat Ndhmëse për Prindin dhe Familjen. Prindërit mund të vizitojnë këto qendra dhe nëpërmjet kompjuterave që ndodhen aty, mund të shikojnë profilet e shkollave dhe të bëjnë pyetje të ndryshme.

Cila është diferenca midis pranimit special, atij me pranim nga i gjithë qyteti dhe shkollave pa përzgjedhje mësimore?

Lotaria për Shkollat e Mesme të Reja/Kensington 2014 Mars

Shkollat me Pranim Special kanë kritere pranimi më konkurruese. Nxënësit që pranohen në shkollat me pranim special duhet të plotësojnë kriteret e shkollës në notat e testeve, notat e lëndëve dhe kërkesave të frekuentimit. *Shkollat me Pranim nga i Gjithë Qyteti*, kanë kërkesa më të ulta për pranim, por gjithsesi ato përsëri kanë kritere të testeve standarde, të notave në dëftesë, të frekuentimit dhe të masave disiplinore. *Shkollat pa kërkesa mësimore, ose shkollat pa kërkesa*, nuk kanë kritere pranimi bazuar në rezultatet mësimore, të frekuentimit, ose të sjelljes.

A mundet një nxënës i caktuar në një arsim alternativ të aplikojë në një prej këtyre shkollave?

Po, të gjithë nxënësit janë të nxitur të aplikojnë në shkollat e reja. Nxënësit e klasave të teta, që janë në arsim alternativ, mund të aplikojnë.

A mundet që nxënësit me IEP, ose që janë nxënës që mësojnë Anglisht të aplikojnë për të ndjekur këto shkolla?

Po, të gjithë nxënësit janë të nxitur të aplikojnë në shkollat e reja. Nxënësit e klasave të teta, që janë me program Edukimi të Individualizuar (IEP), ose që janë nxënës që mësojnë Anglisht, mund të mësojnë më tepër për këtë proces duke kontaktuar këshilltarin e tyre, ose Zyrën e Shërbimeve të Specializuara, me numrin 215-400-4170.

Çfarë është procesi i pranimit?

- Kjo mundësi pranimi është për nxënësit aktualë në klasat e teta, për të vazhduar klasën e nëntë në muajin Shtator 2014.
- Janë të mirëpritur nxënës nga Drejtoria dhe jashtë saj.
- Procesi i aplikimit fillon në 24 Mars 2014 dhe përfundon në orën 5:00 PM të datës 25 Prill 2014.
- Aplikimi nga Lotaria e e Shkollave të Reja të Mesme Kensington, i lejon nxënësit e interesuar në këto shkolla, të renditin preferencat e tyre në përzgjedhje.
- Zyra e Regjistrimit dhe Caktimit të Nxënësve dhe Zyra e Teknologjisë Informativë, do të zhvillojnë një lotari elektronike për përqindjen e vendeve që janë 1) gjeografike (11 kode postare) dhe 2) nga i gjithë qyteti.
- Familjet do të njoftohen për rezultatet e lotarisë.

Cili është afati kohor për këtë proces?

24 Mars: Hapen aplikimet për të tre modelet e reja të shkollave të mesme

25 Prill: Mbyllen aplikimet për të tre modelet e reja të shkollave të mesme

Java e 9 Qershorit: Dërgohen në familjet/nxënësit njoftimet përfundimtare për shkollat e reja.

???? Pyetje ????

Ju lutemi vizitoni http://philasd.org/kensington-new_high_schools_lottery për përditësime dhe informacion shtesë. Në rast se keni pyetje rreth procesit, ju lutemi kontaktoni Zyrën e Regjistrimit dhe Caktimit të Nxënësve në numrin 215-400-5985, ose dërgoni email në 7schoolslottery@philasd.org.